

Ditë 22.07.2024

AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“MLK International” SH.P.K.

NENI 1

Themelohet shoqeria tregtare me perjegjesi te kufizuar “MLK International” sh.p.k., mbeshtetur ne ligjin nr. 9901, date 14.4.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” te ndryshuar, ligjin nr. 9723, date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Bizneseve”, ligjin nr. 9121, date 28.7.2003, “Per Mbrojtjen e Konkurrences”, Kodin Civil dhe Kodin e Punes me ortaku themelues si vijon:

Damaris-Romina Drimbe, datëlindja 12.04.1990, atësia Valentin Romulus, amësia Hurban Lidia, lindur ne Aradea, Rumani dhe banuese në adresën: Oradea city, Bihor county, Vladeasa street No. 16, Romania, me shtetesi Rumune, identifikuar me numer pasaporte 059533333.

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

Selia e Shoqërisë ndodhet në Qytetin e Tiranës në adresën: Rruga Paro Kita, nr. 6/121, Tirane. Shoqeria ka te drejte te hapi filiale te tjera brenda territorit te Republikës se Shqipërisë ne varesi te selise Qendrore që ndodhet ne qytetin e Tiranes.

Vendi i mbajtjes se mbledhjeve te asamblese se pergjithshme eshte selia e shoqerise. Nese bihet dakord me unanimitet mbledhjet e asamblese mund te kryhen ne nje vend tjeter.

KOHEZGJATJA E AKTIVITETIT TE SHOQERISE

NENI 3

Kohëzgjatja e shoqerisë do të jetë e pakufizuar dhe fillon nga momenti i regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit me përashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos Asambleja e Pergjithshme.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Agjencia e rekrutimit të fuqisë punëtore,
- Agjenci e perkoheshme punesimi (Staff leasing)
- Aktivitete ne sektorin e ndërtimit dhe sipermarrjes

KAPITALI I SHOQERISE



KAPITALI I SHOQUERISE

NENI 5

1. Kapitali i shoqërise ka vlerën 100 lekë i cili përbëhet nga 1 kuotë.
2. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast zmadhimi te kapitalit nëpërmjet shtimit te kuotave te reja, ortakët kanë te drejtë e përparësise në nënshkrim, proporcionalisht me shumën e kuotave të tyre, e drejtë nga e cila ata mund të heqin dorë.
3. Kapitali i shoqërisë, mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Zvogëlimi i kapitalit i prek të gjithë ortakët në të njëjtën masë ndaj kuotave të kapitalit që ata përfaqësojnë. Kapitali nuk mund te zvogelohet nen kufirin minimal që lejon ligji "Per tregtaret dhe shoquerite tregtare".

KONTRIBUTET

NENI 6

Kapitali i shoqërisë, zotërohet nga ortaku i vetëm i shoqërisë, Damaris-Romina Drimbe . Ortaku i vetëm Damaris-Romina Drimbe zotëron 100 % të vlerës së kapitalit;

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

NENI 7

1. Ortakët kanë të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e asamblesë se Pergjithshme, dhe ka të drejtën e votës në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij në kapitalin që ai zotëron.
2. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga bashkëshorti ose një person tjetër i zgjedhur prej tij, me kusht që këta të janë autorizuar me prokurë (perjashtohet perfaqësimi i një ortaku nga një ortak tjetër apo administratori i shoqerise).
3. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
4. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.
5. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët, ekspertet kontabel të autorizuar, po që se ka të tille, nga likuiduesit apo ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë. Keta ortake mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkësë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës.



Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës. Njoftimi do te behet me shkresë, ose nepermjet postes elektronike.

6. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
7. Nese në kundërshtim me pikën 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë te procedoje sipas ligjit ne fuqi "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare":
8. Lajmërimi për mbledhjen e asamblesë se pergjithshme rregullisht bëhet nga administratorët.
9. Asambleja e Pergjithshme merr vendime per ceshtjet e me poshtme dhe eshte per gjegjese per to:
 - a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë; ndryshimet e statutit;
 - b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve te shoqerise;
 - c) Emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) Përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe të ekspertëve kontabël te autorizuar;
 - e) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - f) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë. (pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumentacionit perkates);
 - g) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit (pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumentacionit perkates);
 - h) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - i) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë e në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - j) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - k) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - l) Cështje të tjera të parashikuara nga ligji.
10. Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënët e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.



11. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

12. Vendimet e parregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

13. Sipas rëndësisë së vendimeve, mbledhja e asamblesë se per gjithshme mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.

14. Asambleja per gjithshme vodos me shumice te zakonshme për cështje të tilla si emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabel të autorizuar dhe likuiduesve, miratimi i raporteve të administrimit dhe të kontrollit, miratimi i pasqyrave financiare vjetore. Asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 50% te kuotave dhe vendimet merren me me shume se gjysmen e votave te ortakeve pjesemarres.

15. Asambleja e per gjithshme vodos me shumice te kualifikuar për cështje të tilla si ndryshimet e statutit, zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit themeltar, kalimi tek të tretët, zgjatja e kohës së veprimtarisë së shoqërisë apo likuidimi i saj, shndërimi i shoqërise me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera, ndarja e fitimeve si dhe cdo cështje tjetër që parashikohet në ligj. Marrja e vendimeve te vlefshme behet vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se 70% e kuotave jane te pranishem, votojne me shkrese apo mjete elektronike. Ne kete rast vendimet merren me $\frac{3}{4}$ e votave te ortakeve pjesemarres.

16. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur në kete pikë, të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

ADMINISTRIMI

NENI 8

1. Shoqëria administrohet nga një ose me shume administratorë të cilët janë persona fizike të zgjedhur brenda bashkësisë së ortakëve apo dhe jashtë saj.
2. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim të rastit të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm para mbarimit të afatit. Shkarkimi i administratorëve nga organi kompetent mund të bëhet në cdo kohë.
3. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.



4. Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të asamblese se pergjithshme sipas parashikimit ne kete statut.

KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

NENI 9

1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
 - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - g) raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme persa parashikon ky statut ose ligji.
3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

EMERIMI I PARE I ADMINISTRATOREVE

NENI 10

Administrator i shoqërisë për periudhën 5-vjeçare do të jetë ortaku i vetëm z. **Damaris-Romina Drimbe**.

EKSPERTE KONTABEL TE AUTORIZUAR

NENI 11



1. Në rast nevoje si dhe kur kërkohet nga ligji, kontrolli finansiar dhe aprovimi i llogarive vjetore kryhet nga një ekspert kontabel i autorizuar, i emëruar për dy vite financiare me mundësi rizgjedhjeje nga asambleja e per gjithshme me shumice te zakonshme.
2. Shkarkimi i ekspertit kontabël të autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi i tij, në rast se vërehen gabime, abuzime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

E DREJTA E VOTES

NENI 12

Çdo ortak ka të drejta vote në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij.

E DREJTA PER TE KALUAR REZOLUTE

NENI 13

Asambleja e per gjithshme mund te miratoje rezolute pa plotesuar kriteret e njoftimit ne kete statut apo ne ligj. Qe te miratohet një rezolute ne mbledhjen e asamblese se per gjithshme duhet te jene te pranishem te gjithe ortaket personalisht dhe ta votojne ate ne menyre te unifikuar.

ZHVILLIMI I SHOQERISE

NENI 14

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin e saj, seline ligjore, objektin, mund te zmadhoje apo te zvogeloje kapitalin themeltar, mund te pranoje ose te largoje ortake.

MARREDHENIET E PUNES NE SHOQUERI

NENI 15

Shoqeria do te perpiloje dokumentet perkatese per punesimin e personave te trete duke respektuar dispozitat e Kodit te Punes.

VULA E SHOQUERISE

NENI 16

Shoqeria ka vulen e saj ne madhesi te zakonshme me tekstin perreth saj.

FITIMI I PERSONALITETIT JURIDIK

NENI 17

Shoqeria do te rregulloje veprimtarine e saj edhe me Statutin e saj, i cili pasi te nenshkruehet nga ortakët themelues do te fitoje personalitet juridik ne diten e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.



BILANCI DHE FITIMI

NENI 18

- 18.1. Viti finanziar fillon më datë 1 Janar dhe përfundon më datë 31 Dhjetor të çdo viti.
- 18.2. Llogaritë vjetore, inventari raportet mbi operacionet e viti finanziar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël, miratohen nga asambleja e përgjithshme e shoqërisë.
- 18.3. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit finanziar.

FUNKSIONIMI I SHOQERISE

NENI 19

Rregullat per funksionimin dhe drejtimin e shoqerise pervec ketij Akti Themelimi jane te percaktuara ne Statutin e Shoqerise.

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

NENI 20

Te gjitha mosmarreveshjet me organet shteterore, personat juridike e fizike vendas e te huaj, do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas legjisacionit ne fuqi.

DISPOZITA TE TJERA

NENI 21

Ky akt themelimi perpilohet ne kater kopje, duke patur secila kopje fuqi te plete ligjore.

Akti i themelimit nenshkruehet rregullisht nga ortakët themelues të Shoqerise " **MLK International** " sh.p.k.

THEMELUESI I SHOQËRISË
MLK International
Ortaku i vetëm dhe administrator
Damaris-Romina Drimbe



DEINNEE DAMARIS ROMINA -